

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	12. 04 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinstvo Org./Unit	Nr. Prot (tr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKX	1732/2021		1/6

## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.107/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.107/2021 të datës 26.02.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga "Mbretëresha Teuta", në Komunën e Mitrovicës , kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit/Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar ankesa me numër A.nr.107/2021 e datës 26.02.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. **ANULOHEN** Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020, i datës 24.01.2021 dhe Rivlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020, i datës 29.01.2021 për ankuesen
- II. **OBLIGOHET** Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Udhëheqësi Ekzekutiv, i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën nga data 01.01.2020 deri me datën 31.12.2020 në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. **OBLIGOHET** Udhëheqësi Ekzekutiv, që të ndër marrë veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën II të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

#### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, sipas Akt emërimit të datës 28.12.2010, në pozitën "Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim dhe Marrëdhënie me Publikun" me date 24.01.2021 ka pranuar me e-mail nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses respektivisht Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 me të cilin ankuesen e vlerësuar me notën e përgjithshme mjaftueshëm 1.93.

Ankuesja, kundër vlerësimin të rezultateve të punës për vitin 2020 të cilin e ka nënshkruar me datën 25.01.2021, ka shprehur mos pajtimin lidhur me vlerësimin e rezultateve punës që i është bërë dhe ka kërkuar nga Udhëheqësi i saj respektivisht Udhëheqësi Ekzekutiv që ti bëhet rishqyrtimi i vlerësimin të punës.

Pas mos pajtimit dhe kërkesës për rishqyrtim të vlerësimin të punës së ankueses, Udhëheqësi Ekzekutiv në po të njëjtin formular për vlerësimin e punës për ankuesen, te nënshkruar me datë 29.01.2021, tek pjesa e komenteve ka ndryshuar notën e përgjithshme, ku pas rivlerësimin i ka vënë notën 2.23.

Ankuesja e pakënaqur me rivlerësimin e Udhëheqësit Ekzekutiv-mbikëqyrësit të saj, me datën 26.02.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 849/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimin i rezultateve të punës është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore që përcaktojnë obligimet e mbikëqyrësit dhe procedurën e vlerësimin nga mbikëqyrësi, se vlerësimin është bërë pa mbajtur asnjë takim paraprak nga ana e mbikëqyrësit të tij, dhe se vlerësimin ndaj saj nga ana e mbikëqyrësit është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr. 21/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 02.03.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa me datën 08.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me numër protokollit 849/2021 të datës 19.02.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 24.01.2021; E-maili zyrtar i datës 29.01.2021; E-maili zyrtar i datës 24.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 29.01.2021; Kërkesë për vlerësim të punës për vitin 2020 e datës 25.01.2021 nga ankuesja; Plani vjetor i punës për vitin 2020; Plani vjetor/mujor i punës për vitin 2020; Raporti vjetor i punës për vitin 2020; E-maili zyrtar i datës 30.12.2020; E-maili zyrtar i datës 09.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për ankuesen; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 për ankuesen; Mos pajtimi për vlerësimin e formularit të punës për vitin 2019 i datës 26.12.2019; E-mailat zyrtar të datës 18.02.2020; E-maili zyrtar i datës 20.02.2020; E-mailat zyrtar të datës 04.03.2020; E-mailat zyrtar të datës 24.01.2020; E-maili zyrtar i datës 29.03.2020; E-maili zyrtar i datës 19.05.2020; E-maili zyrtar i datës 18.05.2020; E-mailat zyrtar të datës 01.06.2020; E-maili zyrtar i datës 30.06.2020; E-maili zyrtar i datës 09.07.2020; E-maili zyrtar i datës 01.06.2020; E-maili zyrtar i datës 09.07.2020; E-mailat zyrtar te datës 01.06.2020; E-maili zyrtar i datës 10.07.2020; E-maili zyrtar i datës 14.08.2020; E-maili zyrtar i datës 27.08.2020; E-mailat zyrtar të datës 28.08.2020; E-maili zyrtar i datës

09.09.2020; Draft i datës r 07.09.2020; E-maili zyrtar i datës 09.09.2020; E-maili zyrtar i datës 30.09.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 02.03.2021; Përgjigja në ankesë e datës 08.03.2021 me shkresat e bashkëngjitura; E-maili zyrtar i datës 24.01.2021; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të ankueses i datës 09.03.2018; Akt emërim i ankueses i datës 28.12.2010; Formulari.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankueses të kthehet në rivlerësim, sepse :

Bazuar në provat e lëndës respektivisht ndryshimit dhe plotësimit të Aktit të emërimit të datës 09.03.2018 të ankueses rezulton se ankuesja ka themeluar marrëdhënie të punës në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturor në pozitën "Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim, Marrëdhënie me Publikun", e cila i raporton Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi dhe rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020, nuk është objektiv dhe i pabazuar në prova dhe fakte , gjegjësisht vlerësimi i është bërë në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore. Ankuesja pretendon se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020 i është pa pasur asnjë takim paraprak me mbikëqyrësin e saj të drejtpërdrejtë, dhe pa mospajtimin e ankueses lidhur me planin e punës për vitin 2020, sepse sipas saj plani nuk është i hartuar sipas përshkrimit të detyrave të punës, dhe se shumicën e detyrave të punës se ankueses udhëheqësi i ka deleguar të zyraret tjerë pa asnjë arsye duke ia pamundësuar ankueses kryerjen e detyrave të saj . Po ashtu, rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 i është bërë me ngritje të notës së përgjithshme nga 1.93 në 2.23, pasi që ankuesja ka parashtruar mospajtimin e saj me shkrim me datë 29.01.2021 tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, kundër vlerësimit të datës 24.01.2021, e cila sipas pretendimit ankimor ka argumentuar me dëshmi se ka përmbushur dhe ka tejkaluar në tërësi të gjitha objektivat gjatë kryerjes së detyrave të punës për vitin 2020, dhe se vlerësimi si i tillë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe provave të dërguara si nga ankuesja, po ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se formulari i vlerësimit të punës për vitin 2020, ankueses i është dorëzuar me datën 24.01.2021, përmes e-mailit zyrtar nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, e qe data 24.01.2021, sipas kalendarit ka qenë ditë e diel pra ditë pushimi, andaj Kolegji ka konstatuar se vlerësimi i punës për vitin 2020 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ku decidivisht theksohet se: " 1. Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejtë, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses me rastin e nënshkrimit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për

Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: *"Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.vlerësimin (notimi) e objektivave"*, sepse vlerësimi i është dërguar ankueses në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: *"Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit"*, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesja është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit, dhe mbi këtë bazë ankuesja pasi ka pranuar vlerësimin, me datë 24.01.2021 ka paraqit me shkrim mospajtimin e saj, brenda afatit prej 5 ditëve, në pajtim me dispozitën e lartë cekur, dhe po ashtu në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që mbikëqyrësi është takuar me ankuesen gjatë periudhës vlerësuese për të rishikuar progresin e bërë siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e lidhur me mospajtimin me planin e punës për vitin 2020, sepse nuk është i hartuar sipas përshtimit të detyrave të punës ka konstatuar se: ankuesja sipas dëshmive nga shkresat e lëndës të siguruara nga organi i punësimit del se nuk posedon fare përshtimin e detyrave të punës për pozitën që e mban tani *"Nëpunëse e Lartë për Koordinim Teknik, Informim, Marrëdhënie me Publikun"*, sipas ndryshimit dhe plotësimit të Akt emërimit" të datës 09.03.2018. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar planin vjetor të punës për vitin 2020 të ankueses i hartuar nga zyra e Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe Rregulloren Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë dhe ka konstatuar se objektivat e miratuara me planin vjetor të punës për vitin 2020, nuk përkojnë me përshtimin e detyrave të punës së pozitës së ankueses të cilat janë të përcaktuara në nenin 4 paragrafin 4.3 pika 10 të Rregullores Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë. Kolegji konstaton se vlerësimi i arritjes së objektivave për vitin 2020 për ankuesen është bërë në kundërshtim me përshtimin e vendit të saj të punës sipas nenit 4 paragrafit 4.3 pika 10 të Rregullores Nr.02/2010 mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturorë. Kolegji po ashtu konstaton se plani vjetor i punës për vitin 2020 është hartuar në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *"Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit"*, sepse plani i punës duhet të hartohet gjithmonë me pajtim të udhëheqësit të drejtpërdrejtë dhe nëpunësit, duke marrë për bazë përshtimin e detyrave të punës së ankuesit dhe nga ajo pjesë të caktohen objektivat përkatëse për realizimin e veprimtarive ,siç ceket edhe në nenin 6 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku theksohet se : *"Brenda muajit janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi ( vlerësuesi) se bashku me nëpunësin ( i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet"*.



Po ashtu ankuesja ka kontestuar të gjithë kapitujt e vlerësimit nga I-III, sepse vlerësimi i rezultateve të punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real, është tendencioz dhe i pabazuar në prova dhe fakte sepse mos përfshirja e arritjes së objektivave për ankuesen në bazë të detyrave të punës nuk është bazuar në raportet dhe aktivitetet e saj në punë, ku në ë bazë të provave, në vlerësim tek pesë (5) objektivat nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet dhe detyrat e saja te punës, e që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1, 2, 3,4,5,6 dhe 7, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, si dhe duke u bazuar në përmbajtjen e vlerësimit të rezultateve në punë në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se: " **1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësive në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë"**, andaj vlerësuesi/ eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike

Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ankueses dhe organit të punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj eprori aktual është i obliguar që ankueses ti bëjë vlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerrë të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankueses të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me vlerësimin e ankueses për vitin 2020, ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses konkretisht Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me rastin e vlerësimit të ankueses me notën e përgjithshme 1.93 tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njëres prej objektivave dhe detyrave të punës. Po ashtu në lidhje me rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen nga ana e Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se rivlerësimi është bere në kundërshtim me Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe të Nëpunësve të Shërbimeve Publike sepse ne rastin konkret rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 i ankueses i është bërë në po të njëjtin formular të vlerësimit të rezultateve të punës , dhe se vlerësuesi ka bere përmirësime vetëm të dy notave tek dy objektiva, dhe as këtë herë Udhëheqësi i drejtpërdrejtë apo vlerësuesi nuk ka shpjeguar ne komente se pse është rivlerësuar ankuesja me këto nota, për cilat arsye është bere përmirësimi i notave tek dy objektivat, gjegjësisht vlerësuesi nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesja me notën e përgjithshme 2.23 pas rivlerësimit respektivisht vlerësuesi është dashur që në komente të shpjegohet lidhur me përmbushjen e këtyre dy objektivave dhe detyrave të punës.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Udhëheqësin Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, si udhëheqësin më të lartë administrativ që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020 për ankueses si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji si fakt vendimtar lidhur me shqyrtimin e ankesës, mori parasysh edhe faktin notor se viti 2020 ishte vit i përcjellë me situatën e pandemisë me COVID-19, dhe si rezultat i kësaj të gjitha institucionet publike kanë funksionuar me staf esencial dhe reduktime të stafit, rrethana këto që Kolegji vlerëson se kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave të punës, andaj Kolegji bazuar në këto rrethana konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses duhet të bëjë rivlerësimin e Rezultateve të punës për vitin 2020, duke marr parasysh të gjitha faktet e cekuar me lartë.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.107/2021

Ardita PERÇUKU-SHYTI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor ;
- Udhëheqësit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

